

**V E N D I M**  
**Nr.56, datë 11.2.1993**

**PËR FINANCIMIN E SHPËRNGULJES SË FSHATIT MËRTIRAJ-VLORË**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, të Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

1. Të shpërngulet fshati Mërtiraj në lagjen "24 Maj" Vlorë, në banesat që do të ndërtohen për këtë qëllim në vitet 1993, 1994, 1995.
2. Financimi i ndërtimit të banesave do të bëhet për 50 milionë lekë nga buxheti i shtetit dhe 46 milionë lekë nga Albpetroli Patos.
3. Financimi nga buxheti i shtetit do të bëhet: 20 milionë lekë në vitin 1993, 20 milionë lekë në vitin 1994 dhe 10 milionë lekë në vitin 1995.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike, Albpetroli Patos dhe Bashkia e Vlorës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**